РЕГУЛАТОРНА КОМИСИЈА ЗА ЕНЕРГЕТИКА, ВОДНИ УСЛУГИ И УСЛУГИ ЗА УПРАВУВАЊЕ СО КОМУНАЛЕН ОТПАД НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGJETIKËS, I SHËRBIMEVE TË UJIT DHE I SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT ME MBETURINAT KOMUNALE I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 8 paragrafi 3 të Rregullores së Mënyrës dhe të Procedurës së Përcaktimit të Tarifës së Shërbimit të Ujit dhe të Tarifës Rregullatore të Shërbimit të Ujit ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.128/24), Komisioni Rregullator i Energjetikës, i Shërbimeve të Ujit dhe i Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale i Republikës së Maqedonisë Veriut, publikon këtë:

## NJOFTIM

Njoftohen të gjithë personat e interesuar juridikë dhe fizikë se NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Strugë, më 28 maj 2026, deri te Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit ka parashtruar kërkesë për përcaktimin e tarifës së furnizimit me ujë të pijshëm apo të furnizimit me ujë, për periudhën e rregulluar 2027-2029, të regjistruar në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit, nën PA1 nr. 08-238/26 datë 28.5.2026 dhe kërkesën për përcaktimin e tarifës së grumbullimit dhe të largimit të ujërave të zeza urbane, për periudhën e rregulluar 2027-2029, të regjistruar në arkivin e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit, nën PA1 nr. 08-239/26 datë 28.5.2026.

Me kërkesat e parashtruara, NP Ujësjellësi dhe Kanalizimi Strugë kërkon që të hyrat e rregulluara maksimale për secilin vit të periudhës së rregulluar dhe tarifat mesatare për secilin shërbim të ujit, të jenë:

**1. Për furnizimin me ujë të pijshëm apo furnizimin me ujë:**

| | | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|
| Të hyrat e rregulluara maksimale | denarë | 142.413.888 | 157.534.156 | 174.790.735 |
| Sasia e ujit të dërguar | $m^3$ | 1.737.035 | 1.823.888 | 1.915.081 |
| Tarifa mesatare | den/$m^3$ | 77,78 | 81,68 | 85,90 |
| Tarifa mesatare minimale | den/$m^3$ | 73,58 | 76,98 | 80,53 |
| Tarifa mesatare maksimale | den/$m^3$ | 81,99 | 86,37 | 91,27 |

**2. Për grumbullim dhe largim të ujërave të zeza urbane:**

| | | 2027 | 2028 | 2029 |
|---|---|---|---|---|
| Të hyrat e rregulluara maksimale | denarë | 37.466.258 | 41.070.898 | 46.093.597 |
| Sasia e grumbulluar dhe e larguar e ujërave të zeza urbane | $m^3$ | 1.052.446 | 1.105.068 | 1.160.322 |
| Tarifa mesatare | den/$m^3$ | 33,12 | 34,59 | 37,03 |
| Tarifa mesatare minimale | den/$m^3$ | 30,64 | 32,02 | 34,33 |
| Tarifa mesatare maksimale | den/$m^3$ | 35,60 | 37,17 | 39,72 |

Personat e interesuar fizikë dhe juridikë, mendimet dhe propozimet në lidhje me kërkesën e publikuar, mund t'i dorëzojnë më së voni deri më datën 6 korrik 2026, deri në ora 16:00 në Komisionin Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale përmes:

- Postës elektronike: voda@erc.org.mk
- Faksi: 02/ 32 33 586
- Adresa: rr. Maqedonia nr. 25, pallati Llazar Pop-Trajkov, kati i 6 1000 Shkup,

**Shkup, 1.7.2026**

**KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGJETIKËS, I SHËRBIMEVE TË UJIT DHE I SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT ME MBETURINA KOMUNALE I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**